



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 44 Prot

Durrës, më: 30.03.2026

V E N D I M

Nr. 44, datë 30.03.2026

PËR

**"MIRATIMIN E PROJEKT - STRATEGJISË SË PROFILIZIMIT TË FAKULTETIT
TË SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT,
2025-2030"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Senatit Nr.174, datë 17.12.2025; të Vendimit të Rektoratit Nr.4, datë 02.02.2026 pika 4; referuar shkresës Nr. 576/2 prot., datë 03.03.2026 të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, si dhe referuar Vendimit të Rektoratit Nr. 5, datë 18.03.2026 pika 3, në mbledhjen e datës 30.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, përmes ndërkombëtarizimit për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

PROJEKT-STRATEGJIA E PROFILIZIMIT PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT 2025–2030

I. HYRJE

Strategjia e Zhvillimit 2025–2030 e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike (FSHPJ) hartohet në përputhje të plotë me Strategjinë e Profilizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) 2025–2030 dhe dokumentet kombëtare për arsimin e lartë. Ky dokument përfaqëson instrumentin kryesor planifikues për zhvillimin akademik, kërkimor, institucional dhe financiar të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike për periudhën 2025–2030. Ai përcakton drejtimit strategjike, objektivat prioritare, indikatorët e performancës (KPI), mekanizmat e monitorimit dhe përgjegjësitë institucionale.

Strategjia synon:

1. Rritjen e cilësisë akademike
2. Zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit kërkimor-shkencor
3. Rritjen e ndërkombëtarizimit
4. Fuqizimin e impaktit në shoqëri
5. Diversifikimin e burimeve financiare

II. KONTEKSTI INSTITUCIONAL

Fakulteti i Shkencave Politike Juridike u krijua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 685, datë 25.03.2010 dhe përbën një nga njësitë kryesore akademike të Universitetit "Aleksandër Moisiu Durrës.

FSHPJ ka në përbërje të tij tri njësi bazë (departamente), si më poshtë:

1. Departamenti i Drejtësisë (DD)
2. Departamenti i Shkencave Politike (DSHP)
3. Departamenti i Administrimit Publik (DAP)

FSHPJ ofron programe studimi në tri ciklet e studimit si më poshtë:



Programet e Ciklit të parë Bachelor:

1. Drejtësi (Program i Integruar 5-vjeçar)
2. Shkenca Ndërkombëtare e Diplomatie, i cili ofrohet edhe si diplomë e dyfishtë me Universitetin e Gjenovës, Itali
3. Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun
4. Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
5. Administrim Publik
6. Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, i cili ofrohet edhe si diplomë e dyfishtë me Universitetin La Sapienza, Romë, Itali

Programet e Ciklit të Dytë Master Shkencor:

1. E Drejtë Private
2. E Drejtë Ndërkombëtare Europiane e Krahastuar, i cili ofrohet edhe si diplomë e dyfishtë me Universitetin La Sapienza, Romë, Itali
3. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
4. Administrim Publik, i cili ofrohet edhe si diplomë e dyfishtë me Universitetin Cote d'Azur, Nice, Francë
5. Administrim Financiar

Programet e Ciklit të Dytë Master Profesional:

1. E Drejtë Pronës
2. E Drejtë Tregtare Ndërkombëtare
3. Politika Publike
4. Komunikim Publik
5. Drejtëm Turizmi
6. Administrim Financiar

Programet e Ciklit të Tretë "Doktoraturë"

1. E Drejtë Publike, i cili ofrohet si diplomë e dyfishtë me Universitetin Tor Vergata, Itali

III. MISIONI

FSHPJ ka për mision ofrimin e arsimit cilësor në fushën e shkencave juridike, politike dhe administrative, zhvillimin e kërkimit shkencor të orientuar drejt nevojave të shoqërisë dhe kontributin aktiv në forcimin e shtetit të së drejtës, demokracisë dhe qeverisjes së mirë.

IV. VIZIONI 2030

Deri në vitin 2030, FSHPJ synon të jetë një qendër ekselence kombëtare dhe rajonale në arsimin juridik, politik, e administrativ, e profilizuar në kërkim mbi shtetin e së drejtës, qeverisjen dhe integrimin evropian, me profil ndërkombëtar, me ndikim të drejtpërdrejtë në politikëbërje dhe zhvillim institucional.

V. VLERAT THEMELORE

- Cilësia dhe Ekselencia
- Integriteti dhe Transparenca
- Liria Akademike
- Demokracia dhe Përgjegjësia Sociale

- Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja
- Inovacioni dhe Kërkimi Shkencor



VI. ANALIZA E GJENDJES (SWOT 2025)

Duke marrë në konsideratë ecurinë e deritashme të FSHPJ mund të evdientojmë indikatorët përcaktues të analizës së gjendjes (SWOT 2025).

Pikat e forta

Traditë akademike 15-vjeçare
 Staf me tituj dhe grada shkencore
 Kampus modern
 Diversitet programesh studimi
 Pozicionim strategjik në rajonin e Durrësit
 Ndërkombëtarizim i programeve të studimit

Dobësitë

Publikime të kufizuara në revista ndërkombëtare me impakt
 Ndërkombëtarizim i pamjaftueshëm i kurrikulave
 Varësi e lartë nga të ardhurat nga tarifat e studentëve
 Nevojë për modernizim metodash pedagogjike

Mundësitë

Programe Erasmus+ dhe Horizon Europe
 Bashkëpunim me institucione publike
 Rritje e kërkesës për ekspertizë juridike dhe administrative
 Digjitalizimi i proceseve mësimore

Kërcënimet

Ulja e numrit të maturantëve në vend
 Konkurrenca ndëruniversitare sidomos me universitetet private
 Kufizime buxhetore

VII. SHTYLLAT STRATEGJIKE 2025–2030

SHTYLLA 1: CILËSIA AKADEMIKE DHE MODERNIZIMI I PROGRAMEVE

Objektivat

1. Rishikimi i plotë i kurrikulave deri në vitin 2027.
2. Integrimi i metodave interaktive (klinika juridike, moot court, simulime parlamentare).
3. Forcimi i praktikave profesionale.
4. Integrimi i kompetencave digjitale dhe etikës profesionale.

Treguesit kryesorë të performancës

- 100% e programeve të rishikuara
- 70% e studentëve me praktikë të strukturuar
- Rritje e punësueshmërisë me 20%

SHTYLLA 2: KËRKIMI SHKENCOR DHE PROFILIZIMI AKADEMIK

Objektivat

1. Rritja e veprimtarisë kërkimore shkencore sipas grupeve kërkimore të ndara sipas fushave të studimit që mbulon FSHPJ (Shteti i së drejtës dhe reforma në drejtësi; Qeverisja dhe administrimi publik; Integrimi evropian dhe diplomacia; Politika ekonomike dhe zhvillimi rajonal)
2. Rritja e publikimeve shkencore në revista të indeksuara
3. Rritja e projekteve me kërkimore kombëtare e ndërkombëtare



4. Organizimi i konferencave ndërkombëtare me tematika specifike dhe të përgjithshme

Treguesit kryesorë të performancës

- Rritje 30% e publikimeve në revista të indeksuara
- Krijimi i 4 grupeve kërkimore tematike
- Organizimi i 1 konference ndërkombëtare në vit

SHTYLLA 3: NDËRKOMBËTARIZIMI

Objektivat

1. Rritja e numrit të programeve me diploma dyfishe ose duale me universitete partnere
2. 15% e studentëve me eksperiencë mobiliteti ndërkombëtar
3. Ofrimi i programeve të studimit dhe lëndëve specifike në gjuhën angleze

SHTYLLA 4: IMPAKTI DHE ANGAZHIMI PUBLIK

Objektivat

1. Zhvillimi i policy briefs ose furmeve për çështje me interes publik lokal ose kombëtar
2. Marrëveshje të reja me institucione publike lokale, rajonale ose kombëtare
3. Klinika juridike funksionale

SHTYLLA 5: QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE

Objektivat:

- Rritje 25% e të ardhurave jo-buxhetore
- 2 programe të reja profesionale
- Pjesëmarrje në projekte IPA/Horizon, Erasmus+
- Shërbime konsulence për administratën publike


VIII. PLANI I VEPRIMIT 2025–2030

Për secilën shtyllë të zhvillimit është e nevojshme të ketë një plan veprimi si më poshtë:

SHTYLLA 1: CILËSIA AKADEMIKE DHE MODERNIZIMI I PROGRAMEVE				
Objektivi	Aktiviteti	Afati	Përgjegjësi	Indikatori i Performancës
Rishikimi i kurrikulave	Krijimi i grupeve të punës për çdo program	2026	Dekani, Përgjegjësit e Departamentit	Grupet e ngritura
	Rishikimi i syllabuseve dhe përditësimi me literaturë	2025/26	Grupet mësimore	100% silabuse të përditësuara
Integrimi i metodave interaktive	Forcimi i Klinikës së Ligjit	2026/27	DD	Klinikë funksionale dhe e promovuar
	Organizimi i simulimeve si	Çdo vit	DD DSHP	2 aktivitete në vit për çdo departament



	Moot Court, UN Model, Parliament session, Debat i strukturuar		DAP	
Forcimi Praktikave profesionale	Nëshkrimi i marrëveshjeve me gjykata, bashki, zyra noteriale, insitucione shtetërore rajonale e lokale, OJQ.	2026/27	DD DSHP DAP	Çdo departament të ketë 2 institucione të reja në vit. Marrëveshjet të jenë të shoqëruara me përshkrime pune orientuese për çdo student të angazhuar
Integrimi kompetencave digjitale dhe etikës profesionale	Zhvillimi i workshopeve dhe seminarëve për lektorë dhe studentë mbi AI dhe digjitalizimi	2026/27	DD DSHP DAP	Çdo lektor të ketë zhvilluar të paktën një seminar, workshop në vit
SHTYLLA 2: KËRKIMI SHKENCOR DHE PROFILIZIMI AKADEMIK				
Objektivi	Aktiviteti	Afati	Përgjegjësi	Indikatori i Performancës
Rritja e veprimtarisë kërkimore shkencore sipas grupeve kërkimore	Krijimi i 4 grupeve kërkimore sipas tematikave dhe fushave të studimit të FSHPJ	2028/29	Dekani DD DSHP DAP	3-4 grupe kërkimore të reja në FSHPJ
Rritja e publikimeve shkencore në revista të indeksuara	Skemë motivimi për publikime në revista të indeksuara	2028/29	Dekanati	+30% publikime deri në 2030
Konferenca shkencore	Organizimi I konferencës shkencore ndërkombëtare vjetore dhe konferenca tematike me interes publik	2026/27	Departamentet	1 konferencë shkecore ndërkombëtare në vit 1 konferencë në 2 vjet me tematikë për secilin departament
Rritja e projekteve kërkimore	Trajnime për aplikim.	2026/27	Departamentet	Çdo lektor të ketë aplikuar të paktën në një projekt



kombëtare dhe ndërkombëtare	Aplikime në thirrje për projekte kombëtare e ndërkombëtare			kombëtar/ndërkombëtar në vit.
-----------------------------	--	--	--	-------------------------------

SHTYLLA 3: NDËRKOMBËTARIZIMI

Objektivi	Aktiviteti	Afati	Përgjegjësi	Indikatori i Performancës
Rritja e numrit të programeve me diploma dyfishe ose duale me universitete partnere	Negocim me universitete partnere europiane	2027/28	Grupet mësimore	Çdo departament të ketë 1-2 programe me diplomë të dyfishtë në çdo cikël studimi
Studentë me eksperiencë mobiliteti ndërkombëtar	Promovim aktiv i Erasmus + Organizimi i një skeme stimulimi për studentët erasmus	2026/27	Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë	15% mobilitet më shumë për studentët deri në 2030
Ofrimi i programeve të studimit dhe lëndëve specifike në gjuhën angleze	Ofrimi i të paktën 5 lëndëve anglisht në çdo program studimi ose departament	2026/27	Grupet mësimore	5 lëndë aktive anglisht në çdo program studimi/departament 1 program studimi anglisht ose dygjuhësh (shqip/anglisht) për çdo departament deri në 2030

SHTYLLA 4: IMPAKTI DHE ANGAZHIMI PUBLIK

Objektivi	Aktiviteti	Afati	Përgjegjësi	Indikatori i Performancës
Zhvillimi i policy briefs ose furmeve për çështje me interes publik lokal ose kombëtar	Zhvillimi i tryezave, policy brief mbi çështje me interes publik	Çdo vit	Grupet kërkimore	Çdo grup kërkimor 1-2 policy briefs
Marrëveshje të reja me institucione publike lokale, rajonale ose kombëtare	Nënshkim marrëveshje bashkëpunimi me institucionet për kontribut konkret	2026/27	Dekanati	3 marrëveshje çdo vit



Klinika e ligjit funksionale	Promovim I klinikës së ligjit	2026/27	DD Zyra e Komunikimit UAMD	Çdo vit një takim publik informues për performancën. Takimi do të promovohet në rrjetet sociale
------------------------------	-------------------------------	---------	----------------------------	---

SHTYLLA 5: QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE

Objektivi	Aktiviteti	Afati	Përgjegjësi	Indikatori i Performancës
Rritje 25% e të ardhurave jo-buxhetore	Ofrimi I kurseve të formimit të vazhdueshëm	2028	Departamentet	Deri në 2028 çdo departament të ketë evidentuar 1-2 kurse të formimit të vazhdueshëm
Pjesëmarrje në projekte IPA/Horizon, Erasmus+	Aplikime në projekte kombëtare e ndërkombëtare	Çdo vit	Grupet kërkimore	1 - 2 aplikim për çdo grup kërkimor
Shërbime konsulence për administratën publike	Ofrimi i ekspertizës për sektorin publik	2028/29	Stafi akademik	1 kontratë në vit për çdo departament

IX. GRAFIKU GANT I ZBATIMIT

Për të pasur një panoramë të qartë të zbatimit të këtij plani strategjik nevojitet grafiku Gant i mëposhtëm.

Aktiviteti kryesor	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Rishikimi i kurrikulave / silabuseve	x	x				
Ofrimi i simulimeve		x	x	x	x	x
Marrëveshje për praktikave profesionale		x	x	x	x	x
Workshop për kompetenca digjitale		x	x			
Krijimi i grupeve kërkimore sipas fushave				x		
Skema e motivimit për revista të indeksuara				x	x	x
Konferenca shkencore ndërkombëtare e departamentale	x	x	x	x	x	x
Trajnime për aplikime		x	x	x	x	x
Programe me diploma të dyfishta		x	x	x	x	x
Promovim aktiv i mobiliteteve të studentëve			x	x	x	x
Programet / kurset në anglisht		x	x	x	x	x
Policy briefs		x	x	x	x	x
Marrëveshje me institucione të reja			x	x		
Forcimi I klinikës së ligjit			x	x		
Kurset e formimit të vazhdueshëm				x		
Aplikime në projekte ndërkombëtare		x	x	x	x	x



Ofrimi i ekspertizës për sektorin publik				X	X	
Rishikimi i ndërmjetëm i strategjisë			X			

X. KONKLUZION

Strategjia 2025–2030 përfaqëson angazhimin institucional të FSHPJ për të hyrë në një fazë të re zhvillimi, të bazuar në cilësi, kërkim shkencor, ndërkombëtarizim dhe impakt publik. Zbatimi i saj kërkon bashkëpunimin e të gjithë stafit akademikë dhe administrativë, si dhe mbështetjen e organeve drejtuese të Universitetit.